



“Mbrojtja nga konsumimi profesional”

Prof.Asoc.Dr. Izela Tahsini

Online: 7 Qershor 2023, ora 12.00 - 14.00

Ngjarjet e vështira të trevjeçarit të fundit, duke nisur me periudhën e tërmeteve në Shqipëri, e më tej periudhën e pandemisë, kanë ndikuar ndjeshëm në ngarkesën e punonjësve socialë. Në takime e trajnime, rofesionistët shprehen se kujdesi për veten shpesh vjen i fundit dhe se ndiejnë nevojën të kenë një sërë strategjish e teknikash për t’u kujdesur për veten.

Një studim i UNICEF i vitit 2002, në bashkëpunim me Departamentin e Punës Sociale dhe Politikës Sociale, e nënvizoi këtë fakt. 4% e pjesëmarrësve në studim thanë se hasën vështirësi në menaxhimin e ngarkesës së punës në fillimet e pandemisë dhe 56% përzgjedhën konsumimin profesional si një nga vështirësitë me të cilën u përballën. Autorët theksuan se përveç kësaj, përkujdesi për punonjësit socialë është i pakët, dhe rrjedhimisht, rraskapitja e tyre vazhdon¹.

Në këtë kuadër, të folurit për këtë çështje, së pari, i kushton vëmendje vetë profesionistëve, krahas trajnimeve me fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve, dhe nga ana tjetër, përmes ofrimit të strategjive individuale dhe organizative të përkujdesit, ndihmon në parandalimin e konsumimit profesional, dhe rrjedhimisht edhe në ruajtjen e cilësisë së shërbimeve sociale.

Kush mund të marrë pjesë në këtë sesion?

- Studentë dhe profesionistë të punës sociale
- Punonjës të shërbimeve sociale
- Punonjës së sektorit jo-qeveritar
- Profesionistë dhe studiues të rinj të interesuar për çështjet e konsumimit profesional.

¹ Dauti, M., Dhëmbo, E. (2022). *Punonjësit socialë, të rraskapitur dhe të padukshëm gjatë pandemisë COVID-19.* <https://www.reporter.al/2022/05/22/punonjesit-sociale-te-rraskapitur-dhe-te-padukshem-gjate-pandemise-covid-19/>



Qëllimi dhe objektivat e sesionit online

Qëllimi i këtij sesioni online është të prezantojë pjesëmarrësit me konceptin e konsumimit profesional, ndikimin e traumës, si dhe strategjitë individuale dhe organizative për parandalimin e konsumimit profesional. Në mënyrë më specifike, sesioni synon:

- Të njohë pjesëmarrësit me përkufizimin e konsumimit profesional, fazat dhe shenjat e tij
- Të prezantojë pjesëmarrësit me strategjitë individuale për mbrojtjen nga konsumimi profesional
- Të prezantojë pjesëmarrësit me praktikatat e mira organizative për mbrojtjen nga konsumimi profesional
- Të ndihmojë pjesëmarrësit të vlerësojnë nivelin e tyre të rrezikut për konsumim profesional
- Të qartësojë rëndësinë e supervizimit në ruajtjen e profesionistëve nga konsumimi profesional.

Rezultatet e të nxënit

Në fund të sesionit, pritet që pjesëmarrësit:

- Të kenë njohuri mbi përkufizimin, fazat dhe shenjat e konsumimit profesional
- Të zhvillojnë një paketë strategjish individuale për mbrojtjen nga konsumimi profesional
- Të qartësojnë njohuritë e tyre mbi organizatat e shëndetshme/strategjitë organizative për parandalimin e konsumimit profesional
- Të vlerësojnë rëndësinë e supervizimit në ruajtjen e tyre nga konsumimi profesional.

Metodologjia e sesionit:

Sesioni bazohet në një metodologji interaktive. Leksionet e shkurtra janë ndërthurur me diskutimet në grup, ku pjesëmarrësit mund të ndajnë sfidat e tyre në mbrojtjen ndaj konsumimit profesional, strategjitë funksionale dhe ato të dëmshme. Gjithashtu, ushtrimet individuale, testet, dhe ushtrimet në grup, janë pjesë e konsiderueshme e trajnimit, të cilat sigurojnë përforcimin e koncepteve, si dhe zhvillimin e teknikave për mbrojtjen nga konsumimi profesional.



Programi

12.00 – 12.15

Hyrje

- Mirëseardhja!

Prezantim i qëllimit dhe strukturës së sesionit.

2 teste individuale për vlerësimin e nivelit të konsumimit profesional.

12.15 – 13.00

- Trauma direkte dhe indirekte dhe ndikimi i saj te punonjësit e shërbimeve sociale
- Konsumimi profesional, përkufizimi, shenjat dhe fazat
 - o Ushtrim – simptomat e stresit tek profesionistët
 - o Ushtrim – harta e profesionistit ndihmës.

13.00 – 13.45

- Strategjitë individuale për parandalimin e konsumimit profesional
 - o Ushtrim reflektues mbi strategjitë individuale
 - o Diskutim në grup mbi rezultatet e testeve
 - o Ushtrim në grup për strategjitë organizative.
- Faktorët mbrojtës organizativë për parandalimin e konsumimit profesional

13.45 – 14.00

- Përmbledhje e njohurive të fituara; Vlerësim i sesionit